

Me emrin e All'llahut, Gjithmëshirmit, Mëshirplotit

KUR'ANI LIBRI I JETËS

Prof. Muhamed Reza Haxh Khezer

Në suren Bekare, ajeti 121 thuhet: “Ata që u kemi dhënë Librin dhe e lexojnë ashtu siç është shpallur, ata besojnë vërtet në të. Kurse ata që nuk besojnë në të, pa dyshim, janë të humbur.”

Kur i zbritnin ajetet e Kur'anit, Profetin Muhammed (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) e pushtonte një gjendje e habitshme drdhjeje dhe rrënoqethjeje. Në një gjendje të tillë ai hidhte mbi të një mbulesë. Kjo gjendje i ndodhte përshkak të rëndesës dhe vërtetësisë së ajeteve.

Lexuesi a kënduesi i parë i ajeteve të Kur'anit fisnik ka qenë vetë profeti (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), e më pas ai ua mësonte të tjerëve. Leximi a këndimi i ajeteve ka një rëndësi të veçantë e të madhe. Ai është hyrje për mësimin e Kur'anit dhe të urtësisë. Kjo theksohet edhe në suren “El Xhumua”, ajeti 2, ku thuhet: “Është Ai që u solli të analfabetëve një të Dërguar nga gjiri i tyre, për t'u lexuar atyre shpalljet e Tij, për t'i pastruar e për t'u mësuar Librin dhe Urtësinë, ndonëse ata më parë ishin vërtet në humbje të plotë.”

Kuptimin dhe dijen e Kur'anit profeti Muhammed (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) e ka marrë drejtpërsëdrejti nga burimi ndriçues i Kur'anit. Për këtë, besimi i profetit në Kur'an është shumë i thellë dhe madhështor. Kur e lexonte Kur'anin ai ia jepte të drejtën leximit a këndimit dhe kjo e drejtë burontë nga njohja e gjithanshme që kishte ai për Kur'anin.

Pa dyshim, leximi a këndimi që del nga zemra njohëse, ai ndikon shumë në zemrat e të tjerëve. Për këtë, politeistët mekas gjithmonë i këshillonin simpatizantët e tyre që të mos iavinin veshin Kur'anit të Muhammedit dhe kur ta dëgjonin ti' mbyllnin veshët.

Kushdo që lexonte zërin e profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e All'lahut qofshin mbi të!), ai bëhej besimtar.

Sigurisht, leximi a këndimi i bazuar ë njohje është portë hyrëse në praktikimin e vërtetë e të çiltërt të Kur'anit.

Kur'ani, i shpallur nga All'lahu i Madhëruar, ka zbritur për udhëzimin e njerëzve kah ajo që është më e mira, siç thuhet edhe në suren "El Isra", ajeti 9: "Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira..." prandaj, që të kuptohet sa më mirë Kur'anin, duhet që çdo njeri të ketë si shembull profetin Muhammed.

Kur'ani, jo vetëm që është udhëzues, ai është sqarues dhe shpjegues për çdo gjë, siç thuhet në ajetin 89 të sures "En Nahl": "...Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje..." Për këtë, në çdo fushë të jetës, Kur'ani duhet të jetë i pranishëm, sepse ai përmban ligjet më të përkryera për jetën.

Natrisht që Kur'ani është sqarues dhe shpjegues për çdo gjë, por me kusht që të merret si shembull i Dërguari i All'lahut dhe të pastrojmë zemrat që ato të jenë të gatshme për pritjen e rrezeve ndriçuese të Kur'anit fisnik.

Çdo njeri duhet ta konsiderojë Kur'anin shërues, shpëtues dhe libër të jetës.

Ashtu siç thotë edhe vetë Kur'ani, duhet të mendohemi thellë në këtë mrekulli të Krijuesit me qëllim që të gjejmë rrugën e vërtetë e të drejtë.

Kur'ani është si shiu, i cili kur bien ai mund të përfshijë të gjitha tokat. Por nga ky shi përfitojnë më tepër ato toka që janë më të përshtatshme për bimët dhe për pemët. Ndërsa tokat kripore, përshembull, edhe pse në to bie shi, mirëpo në to nuk gjendet prodhimtari, me përjashtim të ndonjë bime apo gjembi që mbijnë sa andej këndeje.

Në vetvete shiu është bujar dhe shumë dobiprurës. Prodhimtaria e tokës varet nga kushtet e tokës dhe aftësitë e bimëve e të pemëve nga përfitimi prej shiut. Në Kur'anin fisnik, thuhet: "Toka e mirë i jep frutat me lejen e Zotit të saj, ndërsa toka e keqe, zor se jep gjë. Kështu, në mënyra të ndryshme, Ne ia shpjegojmë shpalljet Tona njerëzve mirënjohës. (Sure "El A'raf", ajeti 58)

Dhe: “Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje.” (Sure “El Isra”, ajeti 82)

Në suren “El A’raf”, ajeti 52 Kur’ani thotë: “Ne u kemi zbritur atyre një Libër, të cilin e kemi shpjeguar gjerësisht, që të jetë udhërrëfyes dhe mëshirë për njerëzit që besojnë.”

Dhe: “Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit.” (Suren “El Bekare”, ajeti 2)

Kuptimet e këtyre dy ajeteve të sqarojnë se Kur’ani është udhëzues për beimtarët dhe të devotshmit. Ndërsa kundështarët e All’llahut, jo vetëm që nuk përfitojnë nga mësimet dhe udhëzimet e Librit të All’llahut, por ata janë gjithmonë në humbje.

Pra, nëpërmjet të menduarit, të logjikuarit dhe arsyetimit të fortë në Kur’an, ne arrijmë të gjejmë rrugën e drejtë dhe të ecim në të. Rrugën e lumturisë në këtë jetë dhe jetën Tjetër.

Nga ky libër, arrijmë të nxjerrim rregullat që na sigurojnë begatinë e kësaj jete dhe shpëtimin në jetën Tjetër. Mirëpo, kjo ka nevojë që zemrat tona të jenë të shëndosha dhe të përkushtuara në njohjen e All’llahut të Madhëruar dhe të të Dërguarit të Tij. Nëse do të jemi ndjekës të vërtetë të profetit Muhammed (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) dhe zbatues të rregullave e ligjeve të Kur’anit, padyshim që do të jemi të lumtur e të shpëtuar.